



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01 Nr. 08-322/01-1562/22
Kaçanik, 28.01.2022

Në bazë të nenit 12 dhe 14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nevojës për kursimin e Buxhetit të Komunës për furnizimin e shkollave me lëndë djegëse-dru për ngrohje me masën drusore të konfiskuar në vitin 2021, të Propozim Vendimit të DBPZHR 08Nr.322/01-1562/22 prej datës 14.01.2022, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me 28 janar 2022, mori këtë:

VENDIM
PËR NDARJEN E MASËS DRUSORE PËR SHKOLLAVE E KOMUNËS KAÇANIKUT,
TË KONFISKUAR NË VITIN 20201

1. Me këtë Vendim, Lejohet ndarja e masës drusore të konfiskuara në vitin 2021, **161.56 metër kub metër kub (m³)** dru zjarri apo shprehur në metër hapësinore 231 (mh), e cila masë drusore ndodhet në Autoparkun e Shoqatës së Invalidëve të Luftës, atyre shkollave të komunës të cilat si lëndë djegëse për ngrohje shfrytëzojnë masën drusore.
2. Obligohet Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari, të bëjë mbikëqyrjen e shpërndarjes së masës drusore që gjendet në Autoparkun e Shoqatës së Invalidëve të Luftës.
3. Obligohet Drejtoria e Arsimit t'i identifikoj shkollat të cilat kanë nevojë për masë drusore dhe të caktoj sasinë për secilën shkollë në bazë të nevojës.
4. Arsyetimi i ndarjes së masës drusore është dhënë nga DBPZHR në Propozim Vendimin dhe i njëjti është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset; Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltarisë, si dhe Drejtoria e Arsimit.
6. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës – MPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës,
2. Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari,
3. Drejtoria e Arsimit;
4. Drejtoria e Buxhetit dhe Financave; dhe
5. Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality of Kacanik

Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural
dhe Pylltari

08 Nr. 322/07-1562/22
Kaçanik, 14.01.2022

Bazuar në nenin 62 pika 3 dhe 4 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nevojës për kursimin e Buxhetit të Komunës me qëllim të furnizimit të shkollave me lëndë djegëse – dru për ngrohje, masën drusore të konfiskuar për vitin 2021, që ndodhen në Autoparkun e Shoqatës së Invalidëve të Luftës, Kryetari i Komuës z. Besim Ilazi :

PROPOZON

Që Kuvendi i Komunës lidhur me masën drusore të konfiskuar për vitin 2021 të merr:

V E N D I M

PËR NDARJEN E MASËS DRUSORE TË KONFISKUAR - SHKOLLAVE

I.

Lejohet ndarja e masës drusore të konfiskuara në vitin 2021, që ndodhen në Autoparkun e Shoqatës së Invalidëve të luftës, atyre shkollave të komunës të cilat si lëndë djegëse për ngrohje shfrytëzojnë masën drusore.

II

Obligohet DBZHRP-së që të bëjë mbikëqyrjen e shpërndarjes së masës drusore që gjenden në Autoparkun e Shoqatës Invalidëve të Luftës.

III.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë.

IV.

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e marrjes.

ARSYETIM

Duke pasë parasyshë kërkesat e shkollave për masë drusore për ngrohje, shpenzimet e larta që po krijohen me rastin e blerjes së masës drusore për furnizim të shkollave si dhe nevojës për kursimin e buxhetit të Komunës, Kryetari i Komunës z. Besim Ilazi, propozon që të vendoset si në dispozitiv të këtij Propozozim Vendimi, për ndarjen e masës drusore të konfiskuar 161.56 metër kub (m^3) dru zjarri apo shprehur në metër hapsinor 231(mh). Masa drusore e konfiskuar e trupave teknik është $60.54m^3$ ($27.23 m^3$ trupa teknik, pjesë e komunës janë shitur me Ankand Publik, mbeten edhe $3.04m^3$ trupa teknik, që duhet shitur me Ankand Publik). Sipas kontratës numër 01-104/02-24064 të datës 01.07.2017, të lidhur në mes të Kryetarit të Komunës dhe Shoqatës së Invalidëve të Luftës, për ndarjen e masës drusore të konfiskuara ndëmjet Komunës dhe Shoqatës, në raport 50-50%, për shëbimet e ofruara nga ana e SHIL-ës (transporti i masës drusore gjatë konfiskimit, deponimi dhe ruajtja e masës drusore).

**Kryetari i Komunës**
Besim Ilazi